



Duke u mbështetur në nenin 40 paragrafi 40.2 shkronja e) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe në pajtim me nenin 10 dhe 40 të Statutit të Komunës së Klinës, nenit 18 paragrafi 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 si dhe neni 20 i Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale. Nenit 18 dhe neni 21 paragrafi 5 dhe 6 i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Kuvendi i komunës së Klinës në mbledhjen e VIII-të të rregullt për vitin 2023 të mbajtur me datë: 22.09.2023 mori këtë:

V E N D I M

1. Formohet komisioni për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurat e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës.
2. Komisioni i formuar si në pikën 1 të këtij vendimi ka këtë përbërje:
 - 2.1 Luigj Ademi - KK
 - 2.2 Valmire Krasniqi- KK
 - 2.3 Kreshnik Raci -EKZ
 - 2.4 Haki Bajraktari -EKZ
 - 2.5 Vitore Zefi - Nga sektori joqeveritar lokal.
3. Detyrat dhe përgjegjësit e komisionit për shqyrtimin e ankesave janë: shqyrtimi i ankesave të cilat paraqiten nga palët e pakënaqura ofertuese pas procesit të vlerësimit final të ofertave të përzgjedhura nga ana e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës në pajtim me Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale, dhe Rregulloren (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
4. Mandati i këtij komisioni është 2 (dy) vjeçar brenda mandatit të Kuvendit po ashtu Kuvendi i komunës ruan të drejtën e ndryshimit-plotësimit të këtij vendimi kurdoherë që është e arsyeshme.
5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Klinës së Klinës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës (MAPL) në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe neni 8 lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes në web-faqe zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Anëtarët e Komisionit,
- MAPL,
- Kryetari i Komunës,
- Zyra për Informim

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 06-34054 2023
Klinë: 28.09 2023



Kryesuesi,
Fadil Gashi